

VENDIM
Nr.991, datë 10.12.2010

PËR RISHPËRNDARJE FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të bëhet rishpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:

a) Në programin e “Artit dhe kulturës” të pakësohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, për shpenzime korente, dhënë si shtesë nga fondi rezervë i buxhetit, si kontribut për ndërtimin e Parkut Kombëtar Shqiptar “Nënë Tereza”, në Kleveland-Ohio, SHBA.

b) Në programin “Mbështetje për kultet” të shtohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, për shpenzime korente, për mbështetjen e bashkësive fetare.

2. Vendimi nr.718 datë 3.9.2010 i Këshillit të Ministrave “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë e Sporteve, si kontribut për ndërtimin e Parkut Kombëtar Shqiptar “Nënë Tereza”, në Kleveland-Ohio, SHBA”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha